

Perceptimi i Stresit nga ana e Infermierëve dhe “Djegia Profesionale”

Shabani- Bilalli Edona¹; Brajshori Naime¹

Kolegji Heimerer

Stresi profesional paraqet një problem të madh të shëndetit publik. Puna në infermieri është mendërisht dhe fizikisht kërkuese dhe është një nga profesionet më stresuese. Përvës stresit, infermierët po i prek edhe e ashte quajtura Sindromi Burnout, e cila është pasoj e motivimit të tepërt, pritjeve të larta, ngarkesës në punë, faktorëve organizativ etj.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësohet shkalla e perceptimit të stresit dhe “Burnout-it” tek infermierët që punojnë në nivelin e kujdesit primar (QMF) dhe atij sekondar në Rajonin e Gjilanit dhe të bëhet krahasimi ndërmjet tyre.

Metodologjia: Jane përdorur pyetësorët PSS (The Perceived Stress Scale) për të vlerësuar shkallën e perceptuar të stresit dhe MBI (Maslach Burnout Inventory) për të matur nivelin e Burnout-it. Pyetësorëve iu janë shtuar edhe pyetje demografike.

Rezultatet: Studimi tregon se mbi 50% e infermierëve në muajin e fundit janë ndjerë nervoz dhe të stresuar mjaft shpesh dhe shumë shpesh. 39.6% e tyre kanë treguar djegie të lartë profesionale në dimensionin e “Rraskapitjes Emocionale”, 37.4% e tyre kanë treguar djegie të lartë profesionale në dimensionin e “Depersonalizimit”, dhe 36.2% e tyre kanë treguar djegie të lartë profesionale në dimensionin e “Përmbushjes Personale”. Ndërsa në pyetjen: Në muajin e fundit sa shpesh jeni ndjerë nervoz dhe të stresuar, 2.2% e infermierëve që punojnë në kujdesin primar janë përgjigjur me shumë shpesh, ndërsa në po të njëjtën pyetje prej infermierëve që punojnë në kujdesin sekondar me shumë shpesh janë përgjigjur 15.2% e tyre. Kurse në deklaratën: Ndihem i “djegur”/konsumuar nga puna ime, 4.4% e infermierëve që punojnë në kujdesin primar janë përgjigjur me çdo ditë, ndërsa në po të njëjtën deklaratë prej infermierëve që punojnë në spital me çdo ditë janë përgjigjur 8.7% e tyre.

Përfundimet e këtij hulumtimi janë se shkalla e perceptimit të stresit dhe nivelet e “Djegies Profesionale” tek infermierët janë mjaft të larta. Nga to, nivel më të lartë kanë infermierët që punojnë në kujdesin sekondar (spital) në krahasim me ata në nivelin primar (Qendra të Mjekësive Familjare).

Fjalët kyçe: Stres, Burnout, Infermier, Niveli primar, Niveli sekondar